

**KONTRATË DHURIMI TË KUOTAVE TË KAPITALIT THEMELTAR TË
SHOQËRISË "DAAB ENERGY GROUP" Sh.p.k**

Sot, më datën 20.01.2020 (Dymijë e njëzetë), nënshkruhet kjo Kontratë Dhurimi, mes palëve kontraktuese si më poshtë:

PALA DHURUESE:

1. **Z. Fatmir Isufaj**, atësia Shyqyri, lindur në Skrapar më 13-05-1975 dhe banues në Linzë, Tiranë, i pajisur me letërnjoftimin me Nr. Personal H50513171R, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, që zotëron 60% të kuotave të kapitalit themeltar të Shoqërisë "DAAB ENERGY GROUP" Sh.p.k, më poshtë referuar si "**Dhuruesi**".

PALA PRANUESE DHURIMI:

1. **Z. Altin ÇETA**, atësia Tefik, lindur në Rehovë, më 14-06-1975 dhe banues në Tiranë, i pajisur me letërnjoftimin me Nr. 034774538 dhe Nr. Personal H50614053V, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar;
2. **Znj. Vitiola LUSHNJARI**, atësia Vasil, lindur në Lushnje, më 05-08-1979 dhe banuese në Tiranë, e pajisur me letërnjoftimin me Nr. 034937224 dhe Nr. Personal H95805165S, madhore dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar; më poshtë referuar si "**Pranuesit e Dhurimit**".

Më poshtë referuar si veçmas "Pala" dhe së bashku "Palët".

Të dhëna paraprake:

1. Në Qendrën Kombëtare të Biznesit, është regjistruar si person juridik Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "DAAB ENERGY GROUP" Sh.p.k., me NIPT L32127008N.
2. Me Vendimin Nr. 01, datë 20/01/2020 të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve, është vendosur të realizohet dhurimi i kuotave të kapitalit themeltar të Shoqërisë "DAAB ENERGY GROUP" Sh.p.k., nga ortaku Z. Fatmir Isufaj tek pala pranuese e dhurimit Z. Altin Çeta dhe Znj. Vitiola Lushnjari si më poshtë:
 - Z. Fatmir Isufaj do t'i dhurojë **Z. Altin Çeta** 1 (një) kuotë të barabartë me **5% (pesë përqind)** të kapitalit themeltar që ai zotëron në Shoqërinë "Daab Energy Group" Sh.p.k; dhe
 - Z. Fatmir Isufaj do t'i dhurojë **Znj. Vitiola Lushnjari** 1 (një) kuotë të barabartë me **5% (pesë përqind)** të kapitalit themeltar që ai zotëron në Shoqërinë "Daab Energy Group" Sh.p.k.

Palët, madhore dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, vendosën të nënshkruajnë këtë Kontratë të Dhurimit të kuotave të kapitalit themeltar si vijon:

Neni 1 - Objekti i Kontratës:



- 1.1 Objekt i kësaj kontrate është dhurimi i kuotave të Kapitalit themeltar të shoqërisë "Daab Energy Group" Sh.p.k. nga Ortaku Z. Fatmir Sufaj, tek Z. Altin Çeta dhe Znj. Vitiola Lushnjari në cilësinë e pranuesve të dhurimit.

Neni 2 - Përmbajtja e Kontratës

- 2.1 Shoqëria "Daab Energy Group" Sh.p.k është person juridik shqiptar, e regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit më datë 27.09.2013 me Nr. NIPT-L32127008N.
- 2.2 Dhuruesi, Z. Fatmir Isufaj, është ortak i Shoqërisë "Daab Energy Group" Sh.p.k, dhe pronar i 60 % (gjashtëdhjetë përqind) të Kapitalit themeltar të kësaj shoqërie.
- 2.3 Z. Fatmir Isufaj, deklaron se i dhuron Z. Altin Çeta, 1 (një) kuote të barabarte me 5% (pesë përqind) të kapitalit themeltar që ai zotëron në Shoqërinë "Daab Energy Group" Sh.p.k, pa shpërblim dhe pa asnjë kusht dhe Z. Altin Çeta deklaron se e pranon me mirënjohje dhurimin e kësaj kuote të barabartë me 5% të kapitalit themeltar nga Z. Fatmir Isufaj.
- 2.4 Z. Fatmir Isufaj, deklaron se i dhuron Znj. Vitiola Lushnjari, 1 (një) kuotë të barabarte me 5% (pesë përqind) të kapitalit themeltar që zotëron në Shoqërinë "Daab Energy Group" Sh.p.k, pa shpërblim dhe pa asnjë kusht dhe Znj. Vitiola Lushnjari deklaron se e pranon me mirënjohje dhurimin e kësaj kuote të barabartë me 5% të kapitalit themeltar nga Z. Fatmir Isufaj.

Neni 3 - Kalimi i pronësisë

- 3.1 Me nënshkrimin e kësaj kontrate dhuruesi humbet çdo të drejtë reale mbi 10% të kapitalit në këtë shoqëri, ndërsa pranuesit e dhurimit bëhen zotërues të ligjshëm të përqindjeve të kapitalit themeltar të dhuruar nga dhuruesi.
- 3.2 Z. Altin Çeta, me pranimin e dhurimit nga dhuruesi Z. Fatmir Isufaj, bëhet pronar në total i 1 (një) kuote, që përbën 5 % (pesë përqind) të kapitalit themeltar të Shoqërisë "Daab Energy Group" Sh.p.k;
- 3.3 Znj. Vitiola Lushnjari, me pranimin e dhurimit nga dhuruesi Z. Fatmir Isufaj, bëhet pronar në total i 1 (një) kuote, që përbën 5 % (pesë përqind) të kapitalit themeltar të Shoqërisë "Daab Energy Group" Sh.p.k;
- 3.4 Më nënshkrimin e kësaj kontrate dhuruesit marrin përsipër çdo të drejtë dhe detyrim që ka Shoqëria "Daab Energy Group" Sh.p.k.

Neni 4 - Interpretimi i kontratës në tërësi

- 4.1 Çdo kusht apo formulim që mund të sjellë paqartësi do të interpretohet në kontekstin e tërësisë së Kontratës dhe në këndvështrimin e qëllimit që i shty u palët të lidhin këtë Kontratë Dhurimi.

Neni 5 - Legjislacioni i zbatueshëm dhe juridiksioni



5.1 Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin nga interpretimi ose zbatimi i kushteve të kësaj Kontrate, janë objekt shqyrtimi dhe gjykimi para Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Neni 6 - Gjuha e kontratës


6.1 Kontrata përpilohet në 4 (katër) kopje në gjuhën shqipe me vlerë të njëjtë secila dhe nënshkruhet rregullisht nga palët.

PALET

PALA DHURUESE

Z. Fatmir ISUFAJ


FATMIR ISUFAJ



PALA PRANUESE E DHURIMIT

Z. Altin ÇETA

Altin Çeta



Znj. Vitiola LUSHNJARI

Vitiola Lushnjari

